



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 100/2013
Prishtinë, më 03.04.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha – Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Fikrim Damka, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Avdi Kamerolli, Xhemë Veseli dhe Nazmi Gashi – MI; Ukë Gashi - ZPRK; Darsei Canhasi – INDEP; Shqipe Gjocaj – KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.03.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut;
4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 04/L-176 për turizmin;
5. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L-179 për transportin rrugor;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – I njoftoi deputetët se në bazë të evidencës që kemi nga stafi i Komisionit, sot po e mbajmë mbledhjen e njëqindtë (100) të Komisionit. Dhe, me këtë rast, i falënderoi anëtarët e Komisionit për angazhimin dhe punën e tyre në përgjithësi, si dhe partnerët dhe mbështetësit e Komisionit për kontributin e tyre. Pastaj propozoi rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.03.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 26.03.2013 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut

Kryetari - Tha se pas shqyrtimit të Raportit me amendamente edhe nga ana e komisioneve të përhershme për Projektligjin nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut, nuk ka pasur rekomandime apo vërejtje, dhe sipas Rregullores së Kuvendit, duhet të procedohet për në seancë plenare.

Pas debatit, Komisioni nxori unanimisht këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut.*
- 2. Raporti t'i procedohet Kuvendit sipas procedurës për lexim të dytë.*

4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 04/L-176 për turizmin

Kryetari – Theksoi se pas shqyrtimit të Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 04/L-176 për turizmin, po ashtu, nga ana e komisioneve të përhershme, nuk ka pasur ndonjë rekomandim apo vërejtje dhe mund ta procedojmë për në seancë plenare për miratim.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-176 për turizmin.*
- 2. Raporti t'i procedohet Kuvendit sipas procedurës për lexim të dytë.*

5. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L-179 për transportin rrugor

Kryetari – Pas shqyrtimit të Propozim-amendamenteve që janë diskutuar për këtë Projektligj, propozoi që sot të diskutohet vetëm për ato amendamente përmbajtjesore, e jo edhe ato teknike,

për shkak të numrit të madh të tyre. Pastaj, fjalën ia dha znj. Teuta Sahatqija, kryesuese e grupit punues, për t'i prezantuar amendamentet.

Teuta Sahatqija - Tha se është njëri prej projektligjeve që kemi diskutuar më së shumti në mbledhje të grupit punues, por kërkoi që sot në këtë mbledhje të Komisionit të diskutohen vetëm amendamentet që kanë mbetur si çështje të hapura. Pasi që grupit të punës i është dashur t'i hartojë 115 amendamente ku shumica prej tyre, siç tha kryetari, janë teknike apo gjuhësore.

Vërejtjet në projektligj dhe amendamente:

Avdi Kamerolli dhe Xhemë Veseli (përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës) – Kërkuan nga Komisioni parlamentar që të diskutohet edhe një herë **neni 8 apo amendamenti 19**, për shkak se Ministria nuk pajtohet që të fshihet ky nen, sepse nuk mund të fshijmë certifikatën e automjetit. Mirëpo, ai propozoi që paragrafit 2 t'i shtohet teksti: “dhe është pjesë e licencës” dhe të paragrafi 4, të fshihet “tarifa”.

Lutfi Zharku – Tha se në parim është kundër procedurave dhe burokracive, sepse me këtë propozim krijojmë burokraci dhe procedura të panevojshme.

Pas debatit, Komisioni nxori këto amendamente:

Amendamenti 20

Neni 8, paragrafit 2 i shtohet teksti si vijon: “dhe është pjesë e licencës”.

Amendamenti 21

Neni 8, paragrafi 4 riformulohet si vijon:

4. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet, kriteret, dhe procedurat e lëshimit të certifikatës.

Nazmi Gashi (përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës) – Kërkoi të definohet saktë **neni 27, paragrafi 4**, sa i përket çështjes së transportit brenda territorit të Kosovës dhe me amendamentin e propozuar.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Amendamenti 36

Neni 27, paragrafi 4 ndryshohet si vijon:

4. Transporti brenda territorit të Kosovës nga operatorët e transportit rrugor që nuk e kanë selinë në Kosovë, është i ndaluar.

Lutfi Zharku – Propozoi që të rishikohet edhe një herë **neni 64**, sa i përket instalimit dhe inspektimit të aparatit të kontrollit, duke e arsyetuar se kjo është çështje e Departamentit të Metrologjisë, siç është çështja e bazhdarimit, bllobimit dhe kalibrimit.

Avdi Kamerolli (përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës) – Tha se nuk ka kompetenca të përziera, por mund të riformulojmë paragrafin 13 të këtij neni.

Teuta Sahatqija dhe Sala Berisha – Shala – Thanë se duhet të shikohet më qartë, sepse paragrafët: 10,11,12 dhe 13 të këtij neni, janë të njëjtë për nga përmbajtja.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Amendamenti 81

Neni 64, paragrafi 13 riformulohet si vijon:

13. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet, kriteret, procedurat, tarifat, si dhe rregullat tjera sa i përket licencimit të punëtorive (serviseve) të tafografeve.

Hashim Deshishku – Në lidhje me dispozitat ndëshkuese, respektivisht nga **neni 75, deri te neni 79**, kërkoi që të gjitha të zbriten për 50 për qind, sepse janë mjaft të larta.

Lutfi Zharku – Tha se i kemi zbritur dhe janë 23 amendamente, përmes të cilave e kemi zbritur gjobën si vijon: “ 40 euro deri në 400 euro, në 35 euro deri në 350 euro” , si dhe shumë tjetër nga “80 euro deri 800 euro, në 50 euro deri në 500 euro”.

Hashim Deshishku – Përsëriti se edhe me këtë zbritje, nuk pajtohet dhe është kundër këtij ndryshimi, si dhe kërkoi që të bëhet zbritje deri në 50 për qind e dënimeve apo gjobave.

Propozimi i z.Deshishku nuk u përkrah nga Komisioni.

Shaip Muja – Hapi debat në lidhje me **nenin 33**, i cili rregullon fushën e veprimit të taksive. Ai propozoi që të lejohet me këtë ligj edhe veprimtaria e taksive me motoçikleta apo me skuterë, sepse jam konsultuar edhe me legjislacionin e rajonit dhe me ministrinë kemi një dakordim në parim që kjo të lejohet, sepse edhe shteti e ka mekanizimin e ndalimit, nëse e sheh që rrezikohet jeta e qytetarëve.

Propozimin e z.Muja e mbështeti edhe kryetari i Komisionit **z.Pajaziti dhe Teuta Sahatqija**.

Hashim Deshishku – Tha se prej fillimit të shqyrtimit të këtij projektligji apo nga mbledhja e parë, kam qenë që të lejohet edhe kjo veprimtari, pra t’i lejohet biznesit që të zhvillohet edhe në këtë fushë.

Avdi Kamerolli (përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës) – Tha se ne si Ministri, pajtohem në parim, por e kundërshtojmë, sepse nuk kemi infrastrukturë të nevojshme për zhvillimin e kësaj veprimtarie, mirëpo kjo është çështje e komunës dhe propozoi një amendament si vijon: “*Komuna mund të licencojë skuter taxi 1+1 për bartje të udhëtarëve për transport urban, nëse vlerëson se ka infrastrukturë rrugore përkatëse dhe nuk e rrezikojnë sigurinë në komunikacionin rrugor*”.

Shaip Muja – Shtoi se kjo veprimtari është në gjitha vendet dhe është pothuajse edhe ambientale dhe propozoi amendamentin si vijon: “Neni 33, paragrafi 1, ndryshohet si vijon: 1. Transporti taksi lejohet për automjetin me pesë (4+1) ulëse, i cili i ka së paku katër dyer. Dhe, për motoçikleta, një plus një (1+1) ulëse, por vetëm brenda qytetit ”.

Propozimi i z.Muja u përkrah nga Komisioni.

Lutfi Zharku – Në fund të mbledhjes, kërkoi nga stafi i Komisionit që të harmonizojë edhe nenet tjera që nuk kanë amendamente dhe të hartojë amendamente në frymën e ndryshimeve që janë bërë në mbledhje. Respektivisht, në lidhje me afatin e licencës, e cila duhet të jetë jo më pak se pesë vjet dhe të hiqet certifikata CPC për ngasësit brenda vendit, gjithnjë në përputhje me direktivat e BE-së.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me amendamente i grupit punues, me vërejtjet e deputetëve, për Projektligjin nr. 04/L-179 për transportin rrugor.*
- 2. Raporti t’u procedohet Komisioneve të përhershme sipas procedurës.*

6. Të ndryshme

i) Udhëzimet e sigurisë në aeroplan

Lutfi Zharku – Ngriti çështjen në lidhje me moszbatimin e ligjit, sa i përket udhëzimeve të sigurisë në gjuhën shqipe për udhëtarët gjatë udhëtimeve. Ai kërkoi që, si Komision, t'u drejtohen institucioneve përgjegjëse në lidhje me këtë çështje, qoftë inspektoratit ose Autoritetit të Aviacionit Civil apo Ministrisë së Infrastrukturës.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Të kontaktohet me institucionet përgjegjëse dhe të kërkohet raport me shkrim në lidhje me udhëzimet e sigurisë për udhëtarët në aeroplan dhe pastaj të kemi raportim me gojë nga institucioni përgjegjës.

ii) Vizitë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit – AKP

Kryetari – Në vazhden e aktiviteteve, propozoi që si Komision, të bëhet një vizitë pune në Agjencinë Kosovare të Privatizimit – AKP, ku do të merren informata për së afërmi nga zyrtarët përgjegjës, për gjendjen e privatizimit dhe funksionimin e kësaj Agjencie në përgjithësi.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Të vizitohet Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP, brenda këtij muaji, në përputhje me agjendën e Komisionit apo deputetëve në përgjithësi

iii) Propozimi për nismën ligjore për hartimin e Projektligjit për prodhimin, transportin dhe tregtimin biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse

Shqip Muja – Kërkoi nga Komisioni që të merren të gjitha masat, për procedurat e mundshme për nismën ligjore për hartimin e Projektligjit për prodhimin, transportin dhe tregtimin biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse. Ai tha se përditë e më shumë po kemi vërejtje si shtet, që të menaxhojmë më mirë këtë çështje. Përmes këtij ligji, të ruajmë edhe ambientin, i cili sipas raporteve, është në një gjendje jo të mirë.

Kryetari – Ne e kemi një praktikë, ku përmes së cilës bëjmë monitorimin e ligjit dhe pastaj nxjerrim rekomandime, dhe nëse vërejmë se ligji nuk është i zbatueshëm, fillojmë dhe e hartojmë amendamentimin e tij.

Teuta Sahatqija – Tha se ne e kemi pranuar në email Projektligjin për naftën dhe aty mund të shohim se çfarë mundësish mund të kemi dhe të përfshijmë edhe këtë çështje.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Të ftohen për debat përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për të debatuar në lidhje me nismën ligjore për hartimin e Projektligjit për prodhimin, transportin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse dhe pastaj të vazhdohen procedurat për këtë nismë ligjore.

iv) Çështjet vijuese

Kryetari – Në fillim të mbledhjes e potencova se kjo është mbledhja e njëqindtë (100) e Komisionit dhe do të shohim në ditët e ardhme, kur të jetë i tërë Komisioni prezent, të kemi një drekë pune, në të cilën do të diskutohet edhe për planet dhe sfidat e Komisionit në të ardhmen.

Propozimi i kryetarit u përkrah unanimit nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit